



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

**Kryesues i KD – së**  
Prof. Ass. Dr. Ilir Mazreku

Nr. Prot. 2815 Dt. 08.11.2022

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 08.11.2022, mori:

**VENDIM**

1. Për aprovimin e Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e përgjithshme në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet çdo rregullore apo vendim lidhur me Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e përgjithshme në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë.
3. Këtij vendimi i bashkëngjitet Rregullorja mbi Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e përgjithshme në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim i dorëzohet:

1. Arkivit të UIBM – së,
2. Fakulteteve,
3. Zyrës për informim dhe komunikim me publikun
4. Zyrtarit ligjor.

Kryesues i Këshillit Drejtues

Prof. Ass. Dr. Ilir Mazreku





**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

Nr. Prot. 2815 Dt. 08.11.2022

Në mbështetje të nenit 24 të Statutit, si dhe në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Këshilli Drejtues (KD) i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur me datën 08.11.2022, miratoi:

**Rregullat dhe Procedurat për  
Zgjedhjet e përgjithshme në UIBM**

1. Dispozitat e përgjithshme
2. Rregullat zgjedhore
3. Listat e votuesve
4. Kandidatët
5. Regjistrimi i kandidatëve
6. Komisioni Qendror Zgjedhor
7. Komisionet Zgjedhore të Fakulteteve
8. Dita e zgjedhjeve
9. Procedurat e votimit dhe fletëvotimet
10. Rezultatet e zgjedhjeve – hedhja e shortit
11. Periudha e ankesave

**1. Dispozitat e përgjithshme**

**Neni 1**

(1) Të gjitha rregullat dhe procedurat e mëtejme duhet t'i referohen dhe të bazohen në Statutin e Universitetit "Isa Boletini" të Mitrovicës, Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës dhe aktet tjera normative në fuqi.

(2) Çdo ankesë kundër vendimeve të bazuara në këto rregulla dhe procedura duhet të adresohen:

- së pari tek Komisioni Qendror Zgjedhor
- së dyti tek Këshilli Drejtues i UIBM – it

**Neni 2**

(1) Zgjedhjet si më poshtë i shpallë Këshilli Drejtues dhe do të mbahen në 6 fakultetet e UIBM – it, sipas nenit 24 dhe 69 të Statutit:

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; [info@umib.net](mailto:info@umib.net); Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

---

1. Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e profesorëve;
  2. Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e asistentëve;
  3. Anëtari i këshillave të fakulteteve nga radhët e personelit jo – akademik;
  4. Anëtar i Senatit nga radhët e personelit akademik;
  5. Anëtari i Senatit nga radhët e personelit jo – akademik.
- (2) Zgjedhjet për anëtarë të Senatit nga radhët e personelit jo – akademik, siç është definuar në pikën 5 të këtij neni, do të mbahen edhe në Administratën Qendrore.

**Neni 3**

(1) Personeli akademik i UIBM – it përfshin grupet, siç ceket në nenin 164 pika 2 të Statutit të UIBM:

1. Profesor i rregullt
2. Profesor i asocuar
3. Profesor asistentë
4. Asistentë universiteti
5. Lektorë

**Neni 4**

- (1) Të gjithë mandatarët të cilët zgjidhen ligjshëm përmes këtyre zgjedhjeve, do të mbajnë mandatin e tyre për katër vite.
- (2) Në rast të dorëheqjes, ndërprerjes së kontratës, pensionimit, vdekjes, përjashtimit të mandatarit apo për shkak të ndonjë arsyeje tjetër, mandati do t'i takojë personit të parë të pazgjedhur sipas rezultateve fillestare të zgjedhjeve, të dala nga votat e fituara.
- (3) Në rastet kur nuk ka persona në dispozicion nga rezultatet fillestare të zgjedhjeve mandatet do të mbeten të paushtruara deri në zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme.

**Neni 5**

- (1) Secili anëtar i personelit të UIBM – it me kontratë të plotë (primare) do të ketë të drejtë të marrë pjesë në këto zgjedhje.
- (2) Në mënyrë që të kenë të drejtë të radhiten si
- a. votues
  - b. kandidat
- (3) Personeli duhet t'i zbatojnë rregullat siç janë cekur në:
1. Nenin 163 pika 1 të Statutit, që thotë se "Personeli në marrëdhënie të rregullt pune nuk mund të ketë



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

---

kontratë tjetër të punësimit me normë të plotë brenda apo jashtë universitetit.”

2. Dispozitat e Ligjit për zyrtarët publik dhe legjislacionit në fuqi.

(4) Në rastet e kontestueshme sipas paragrafit 2 të këtij neni, në lidhje me të drejtën për të votuar ose të drejtën për kandidim, vendimi duhet të merret nga Komisioni Qendror Zgjedhor.

(5) Për çdo vendim negativ sipas (3) ankimi mund të i drejtohet Këshillit drejtues.

**2. Rregullat zgjedhore**

**Neni 6**

(1) Anëtarët e këshillit të fakultetit nga radhët e profesorëve do të zgjidhen nga profesorët e këtij fakulteti siç përcaktohet në nenin 168 (profesor i rregullt), 169 (profesor i asocuar) dhe 170 (profesor asistent) të Statutit.

(2) Këshilli i fakultetit i ka deri në tridhjetë (30) anëtarë (Neni 69, pika 2 e Statutit të UIBM).

(3) Anëtarë të këshillit të fakultetit do të zgjidhen deri 20 (njëzet) profesorë (Neni 69, pika 3.4 e Statutit të UIBM).

(4) Në të gjitha fakultetet e tilla ku numri i përgjithshëm i profesorëve – siç përcaktohet në (1) të këtij neni – nuk e kalon numrin 20, të gjithë profesorët caktohen automatikisht si anëtarë të këshillit të fakultetit. Në këtë rast nuk do të mbahen zgjedhje.

(5) Në të gjitha fakultetet e tilla ku numri i përgjithshëm i kandidatëve profesorë të regjistruar nuk e tejkalon numrin 20, të gjithë kandidatët e regjistruar automatikisht caktohen si anëtarë të këshillit të fakultetit. Në këtë rast nuk do të mbahen zgjedhje dhe mandatet do të mbeten të lira nëse nuk plotësohet numri.

**Neni 7**

(1) Anëtarët e këshillit të fakultetit nga radhët e asistentëve do të zgjidhen nga personeli akademik i fakultetit siç përcaktohet në nenin 163 pika 2 dhe përshkruhet në hollësi në nenet 168 (profesor i rregullt), 169 (profesor i asocuar), 170 (profesor asistent) dhe 171 të Statutit (asistent).

(2) Numri i asistentëve të zgjedhur në këshillin e fakultetit është më së shumti 6 (gjashtë) anëtarë.

(3) Në të gjitha fakultetet e tilla ku numri i përgjithshëm i asistentëve nuk e tejkalon numrin 6, të gjithë kandidatët e regjistruar automatikisht caktohen si anëtarë të këshillit të fakultetit. Në këtë rast nuk do të mbahen zgjedhje dhe mandatet do të mbeten të lira nëse nuk plotësohet numri.

**Neni 8**

(1) Anëtarët e Senatit nga radhët e personelit akademik do të zgjidhen nga personeli akademik i secilit fakultet siç përcaktohet në nenin 163 pika 2 dhe përshkruhet në hollësi në nenet 168 (profesor i rregullt), 169 (profesor



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
“ISA BOLETINI”  
MITROVICË**

---

i asocuar), 170 (profesor asistent) dhe 171 (asistent) të Statutit.

(2) Një anëtar i personelit akademik do të zgjidhet si anëtar i Senatit nga secili fakultet.

**Neni 9**

(1) Sekretari i Fakultetit është anëtar ex officio i këshillit të fakultetit me të drejtë vote.

(2) Një anëtar i personelit jo – akademik do të zgjidhet si anëtar i këshillit të fakultetit.

(3) Dy (2) përfaqësues të studentëve, të zgjedhur nga këshilli i studentëve të fakultetit janë anëtarë të këshillit të fakultetit.

**Neni 10**

(1) Një anëtar i Senatit nga radhët e personelit jo – akademik do të zgjidhet nga personeli jo – akademik i të gjitha fakulteteve dhe i Administratës Qendrore të UIBM – it, ashtu siç përcaktohet në Statut neni 44 pika 1 nënpika 1.6.

(2) Në rast të votave të barabarta të kandidatëve për mandatin e anëtarit të Senatit nga personeli jo akademik, përparësi do ti jepet kandidatit të gjinisë femërore.

(3) Dy (2) anëtarë të zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve prej radhëve të studentëve të rregullt të Universitetit. Studentët anëtarë të Senatit duhet të jenë studentë të dalluar me notë mesatare së paku tetë (8) dhe nuk duhet të jenë përsëritës të vitit akademik.

**3. Listat e votuesve**

**Neni 11**

(1) Administrata e fakulteteve dhe Administrata Qendrore ka për detyrë t'i ofrojë të dhënat e kompletuara të votuesve me të drejtë vote Komisionit Qendror Zgjedhor.

(2) Në rast të vonesës ose refuzimit për të dorëzuar të dhënat nga ndonjë fakultet, do të merren masa disiplinore nga ana e Këshillit Drejtues pas njoftimit nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor.

**Neni 12**

(1) Një listë e votuesve me të drejtë vote do të përgatitet nga Komisioni Qendror Zgjedhor për secilin nga 6 fakultetet dhe administratën qendrore, duke përfshirë të dhënat në vijim:

Personeli akademik:

- Numri rendor
- Emri
- Mbiemri
- Data e lindjes



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

---

- Numri personal
- Grada shkencore – Titulli profesional
- Departamenti

Personeli jo – akademik:

- Numri rendor
- Emri
- Mbiemri
- Data e lindjes
- Numri personal
- Pozita
- Zyra/Njësia

**4. Kandidatët**

**Neni 13**

- (1) Secili anëtar i personelit të UIBM – it që është regjistruar në listën e votuesve ka të drejtë të regjistrohet si kandidat për mandat siç ceket në nenin 1.
- (2) Të qenit anëtar në Komisionin Qendror Zgjedhor ose në ndonjë komision zgjedhor të fakultetit nuk është pengesë për të qenë kandidatë në zgjedhjet e përgjithshme.
- (3) Votuesit me të drejtë vote kanë të drejtë të regjistrohen për më shumë se një mandat.
- (4) Në qoftë se një anëtar i personelit zgjidhet për më shumë se një mandat, pozita në Senat mbizotëron në krahasim me pozitën në Këshill të fakultetit. Komisioni Qendror Zgjedhor ka për obligim t'i qartësojë përsëritjet e këtylla në emërime para shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.
- (5) Nuk lejohet ushtrimi i më shumë se një mandati. Nëse një anëtar i personelit shkel mbi këtë parim, Komisioni Qendror Zgjedhor i revokon të gjitha mandatet e këtij personi. Procesi i zëvendësimit të mandateve pastaj bëhet sipas mënyrës së përshkruar në nenin 4 të kësaj Rregullore.

**5. Regjistrimi i kandidatëve**

**Neni 14**

- (1) Secili votues me të drejtë vote ka të drejtë të regjistrohet si kandidat për ndonjë mandat që i është caktuar kategorisë së tij/saj dhe fakultetit.
- (2) Duhet të përgatiten procedurat e regjistrimit për secilin fakultet.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
“ISA BOLETINI”  
MITROVICË**

---

- (3) Komisioni zgjedhor i fakultetit duhet të caktojë një periudhë për regjistrim prej orës 08:00 dhe 16:00 gjatë ditës së regjistrimit, datë e cila do të shpallet nga Komisioni Qendror Zgjedhor.
- (4) Dita e regjistrimit duhet të jetë së paku 2 ditë para ditës së zgjedhjeve.
- (5) Votuesit me të drejtë vote të cilëve u pamundësohet pjesëmarrja në procedurat e regjistrimit duhet t’iu jepet mundësia të regjistrohen përmes aplikacioneve të shkruara.
- (6) Një formular përkatës për regjistrim, shtojca 1, do të jetë në dispozicion në dekanate dhe në ueb faqen e UIBM – it.

**Neni 15**

- (1) Komisioni Qendror Zgjedhor është i obliguar të kontrollojë çdo regjistrim të kandidaturës për validitet, duke iu referuar listës së votuesve dhe dispozitave të këtyre rregullave dhe procedurave.
- (2) Lista zyrtare e kandidatëve do të përgatitet nga Komisioni Qendror Zgjedhor për secilin fakultet dhe administratën qendrore duke përfshirë të dhënat në vijim:

Personeli akademik:

- Numri rendor
- Emri
- Mbiemri
- Data e lindjes
- Numri personal
- Grada shkencore – Titulli profesional
- Departamenti

Personeli jo – akademik:

- Numri rendor
- Emri
- Mbiemri
- Data e lindjes
- Numri personal
- Pozita
- Zyra/Njësia

- (3) Lista zyrtare e kandidatëve do të publikohet nga Komisioni Qendror Zgjedhor në ditën e zgjedhjeve në dekanatet e fakulteteve dhe në ueb faqen e UIBM – it.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

---

**6. Komisioni Qendror Zgjedhor**

**Neni 16**

- (1) Komisioni Qendror Zgjedhor do të përmbushë obligimet e veta, siç ceket në Statutin e Universitetit dhe aktet tjera ligjore.
- (2) Këshilli Drejtues e themelon Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ). KQZ parimisht përbëhet nga një profesor i universitetit, sekretari i përgjithshëm dhe një asistent i universitetit.

**Neni 17**

Secili anëtar i personelit do të ketë të drejtën të ankohet kundër vendimeve të Komisionit Qendror Zgjedhor sipas (4) në formë të shkruar dhe me arsyetim të bazuar tek Këshilli Drejtues i Universitetit. Vendimi rreth ankesës duhet të merret brenda 4 javëve pas pranimit. Vendimi i Këshillit Drejtues është vendimtar.

**7. Komisionet Zgjedhore të Fakulteteve**

**Neni 18**

- (1) Secili Komision Zgjedhor i Fakultetit duhet të përbëhet nga tre anëtarë:
1. Sekretari i fakultetit
  2. Një profesor i respektuar i fakultetit, i nominuar nga këshilli i fakultetit
  3. Një asistent i respektuar i fakultetit, i nominuar nga këshilli i fakultetit
- (2) Sekretari i fakultetit duhet të kryesojë komisionin e zgjedhjeve.
- (3) Zgjedhja e dy anëtarëve tjerë të KZF nga radha e stafit akademik bëhet me shumicë absolute (50+1) të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit të fakultetit përmes votimit të fshehtë.
- (4) Nëse asnjë kandidat pas votimit të parë nuk ka marrë shumicën absolute të votave, në votimin e dytë zgjidhen kandidatët që kanë marrë më së shumti vota sipas pikës (1).2 dhe (1).3.
- (5) Protokollet e komisionit të zgjedhjeve duhet të përgatiten dhe nënshkruhen nga kryesuesi dhe anëtarët e KZF.
- (6) Mbledhjet e komisionit zgjedhor të fakultetit thirren nga kryesuesi i KZF me pëlqimin e Komisionit Qendror Zgjedhor.

**8. Dita e zgjedhjeve**

**Neni 19**

- (1) Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të vendosë dhe të shpallë ditën e zgjedhjeve.
- (2) Në ditën e zgjedhjeve, vendvotimet duhet të hapen nga ora 08:00 deri në 16:00.

**Neni 20**





**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
“ISA BOLETINI”  
MITROVICË**

---

(1) Votuesit me të drejtë vote duhet që personalisht të hedhin votën në vendvotim të fakultetit, në të cilin janë caktuar sipas kontratës së tyre.

(2) Asnjë votues nuk duhet të ketë të drejtë të votojë në më shumë se një vendvotim.

**Neni 21**

Komisioni Qendror Zgjedhor në bashkërendim me komisionet zgjedhore të fakulteteve duhet të shpallin lokacionin e vendvotimeve.

**Neni 22**

Zgjedhjet duhet të mbahen nga komisionet zgjedhore të fakulteteve, nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror Zgjedhor.

**9. Procedurat e votimit dhe fletëvotimet**

**Neni 23**

(1) Gjatë kohës së votimit, së paku dy anëtarë të komisionit zgjedhor të fakultetit duhet të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës për të siguruar mbarëvajtje të rregullt të procedurave zgjedhore.

(2) Komisioni zgjedhor i fakultetit duhet të sigurojë hapat e mëtejme procedural për mbarëvajtje të zgjedhjeve:

- Hapja dhe mbyllja e vendvotimit në kohën e caktuar dhe mbajtja e vendvotimit; hapur gjatë periudhës së caktuar së zgjedhjeve;
- Ofrimi i materialeve të nevojshme për mbajtjen e votimeve;
- Shpërndarja e materialeve zgjedhore;
- Shënimi i procedurave të votimit në protokollin e komisionit zgjedhor;
- Vulosja e kutive të votimit dhe shënimi i numrave të vulave;
- Shënimi i sasisë dhe numërimi i votave;
- Shënimi i rezultateve të zgjedhjeve.

**Neni 24**

Procedura zgjedhore duhet të përmbajë hapat në vijim:

- Komisioni i zgjedhjeve kërkon nga votuesi të identifikojë vetveten me dokument të identifikimit (letërnjoftim);
- Komisioni i zgjedhjeve kërkon nga votuesi që të identifikohet me një nga kategoritë e personelit;
- Komisioni i zgjedhjeve e gjen votuesin në listën e votuesve;
- Komisioni zgjedhor kërkon nga votuesi të regjistrohet në listën e votuesve;

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; [info@umib.net](mailto:info@umib.net); Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
“ISA BOLETINI”  
MITROVICË**

---

- Komisioni zgjedhor i jep votuesit fletëvotimet e përshtatshme;
- Votuesi fshehtazi shënon fletëvotimin në kabinën e votimit;
- Komisioni zgjedhor zëvendëson një fletëvotim sipas kërkesës nëse votuesi e ka dëmtuar atë;
- Votuesi e hedhë votën në kutinë e votimit;
- Votuesi del nga vendvotimi menjëherë pas votimit;
- Komisioni zgjedhor shënon në protokoll çdo ndryshim të këtyre procedurave.

**Neni 25**

- (1) Secili fletëvotim duhet të përmbajë emrat e të gjithë kandidatëve të cilët janë regjistruar për mandate të caktuara. Kandidatët duhet të radhiten në fletëvotim sipas mbiemrave dhe emrave.
- (2) Secili votues ka të drejtë të shënojë aq kandidatë sa edhe ka mandate në konkurrim në zgjedhjet e caktuara. Një lajmërim i përshtatshëm duhet të jepet në fillim të fletëvotimit.
- (3) Fletëvotimet janë valide kur maksimumi i kandidatëve të paracaktuar ose më pak – siç ceket në fletëvotim – janë shënuar dhe kur qëllimi i votuesit është i qartë.
- (4) Fletëvotimet janë jo-valide kur shënohen më shumë kandidatë sesa maksimumi i përcaktuar – siç ceket në fletëvotim – ose kur nuk shënohet asnjë kandidatë.
- (5) Në të gjitha rastet e tjera të kontestimit të validitetit të fletëvotimit, vendimi duhet të merret nga Komisioni Qendror Zgjedhor sipas kërkesës së komisionit zgjedhor të fakultetit.

**Neni 26**

Secili votues me të drejtë vote ka të drejtë të dorëzojë ankesë në lidhje me procedurat e zgjedhjeve tek Komisioni Qendror Zgjedhor. Formulari përkatës, shtojca 2 do të jetë në dispozicion në secilin vendvotim në fakultete dhe në ueb faqen e UIBM – it.

**10. Rezultatet e zgjedhjeve – hedhja e shortit**

- (1) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i obliguar të shpallë rezultatet zyrtare të zgjedhjeve brenda 24 orëve pas mbylljes së vendvotimeve.
- (2) Në rastet kur dy ose më shumë kandidatë kanë marrë numrin e njëjtë të votave për një numër joadekuat të mandateve në dispozicion, atëherë duhet të organizohet hedhja e shortit nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që do të vendos për ndarjen përfundimtare të mandateve.
- (3) Ky short duhet të organizohet brenda 48 orëve pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve.

**11. Periudha e ankesave**

- (1) Pas shpalljes zyrtare të rezultateve, shpallet një periudhë 3 – ditore për ankesa.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

---

- (2) Gjatë kësaj periudhe mund të dorëzohen ankesa me shkrim në lidhje me procedurat e zgjedhjeve, rezultatet e votimeve dhe mandatarët.
- (3) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka për detyrë të vendosë rreth të gjitha ankesave brenda periudhës së ankesave.
- (4) Pas përfundimit të kësaj periudhe, Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të shpallë rezultatet zyrtare të zgjedhjeve.

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje (Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e përgjithshme në UIBM) shfuqizohet Rregullat dhe procedurat e zgjedhjeve të përgjithshme në UMIB, nr. prot. 529 e datës 28.03.2019.

Prof. Ass. Dr. Hjr Mazreku

Kryesues i KD





---

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TË PËRGJITHSHME**

**Formular aplikimi  
për zgjedhjet e përgjithshme**

---

Dua të regjistrohem si kandidatë për<sup>1</sup>

- anëtar i këshillit të fakultetit nga radhët e profesorëve
- anëtar i këshillit të fakultetit nga radhët e asistentëve
- anëtarë i Senatit nga personeli akademik
- anëtar i këshillit të fakultetit nga personeli joakademik
- anëtar i Senatit nga personeli joakademik

Fakulteti \_\_\_\_\_

Emri \_\_\_\_\_

Mbiemri \_\_\_\_\_

Data e lindjes \_\_\_\_\_

Titulli akademik<sup>2</sup> \_\_\_\_\_

Profesioni<sup>3</sup> \_\_\_\_\_

Departamenti<sup>4</sup> \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

Nënshkrimi \_\_\_\_\_

<sup>1</sup> shënoni (zgjidhni) opsionin e duhur duke shënuar katrorin me (x)

<sup>2</sup> vetëm për personelin akademik

<sup>3</sup> vetëm për personelin joakademik

<sup>4</sup> vetëm për personelin akademik



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TË PËRGJITHSHME**  
**FOMULARI I ANKESËS**

**T’I DËRGOHET KOMISIONIT QENDROR ZGJEDHOR**

**USHTRUESI I ANKESËS:**

Emri \_\_\_\_\_

Mbiemri \_\_\_\_\_

Fakulteti \_\_\_\_\_

**KRYESI I SUPOZUAR I SHKELJES:**

Emri \_\_\_\_\_

Mbiemri \_\_\_\_\_

Fakulteti \_\_\_\_\_

**SHKELJA E SUPOZUAR**

Përshkruani shkeljen e supozuar në hollësi; luteni të përfshini vendin, datën dhe kohën kur ka ndodhur shkelja e supozuar.

Lutni të bashkangitni fletë shtesë nëse është e nevojshme.

Data \_\_\_\_\_

Nënshkrimi \_\_\_\_\_

Për çdo shkelje të supozuar kërkohet nga një formular i veçantë